Shpallje për vende të lira pune

Inspektor i Policia Bashkiake

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.89/2022, "Ligji për Policinë Bashkiake", në "Urdhërin e përbashkët për miratimin e Rregullores së brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake"; Vendimit Nr.313, datë 01.07.2002 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës", të ndryshuar; Ligjit Nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjin nr.44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

Bashkia Lushnje shpall konkursin për vende të lira pune në pozicionin:

Inspektor i Policise Bashkiake

Kandidatët për inspektor i Policise Bashkiake duhet të plotësojnë kërkesat si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;

-Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

-Të ketë përfunduar arsimin e lartë;

-Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;

-Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

-Të mos jetë larguar nga policia e shtetit dhe garda e republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e policisë së shtetit;

-Të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë :

· Kërkesë për aplikim (me shkrim dore) ;
· Jetëshkrim;
· Fotokopje e kartës së identitetit;
· Çertifikatë e përbërjes familjare;
· Librezë ushtarake ose vërtetim nga dega e mobilizimit ushtarak(në rast se ka);
· Diplomën e shkollës dhe listën e notave, të noterizuara;
· Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
· Librezë pune e plotësuar
· Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
· Raport mjeko-ligjor për ushtarakë;
· Vërtetim i gjendjes Gjyqësore (dëshmi penaliteti)
· Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi)
· Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor)
· Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave (që nuk është person fizik dhe juridik);
· 2 Fotografi (një copë 9 x 6 cm dhe një copë 2.5 x 3.5 cm).
· Listë e inventarizuar e dokumentacionit të dorëzuar, e nënshkruar nga kandidati

F USHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË TESTOHEN

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a. Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar
b. Njohuritë mbi Ligjit Nr.89/2022, “Ligji për Policinë Bashkiake”
c. Njohuritë mbi Rregulloren së Brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës.
d. Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.
Kandidatët në *intervistën me gojë* do të vlerësohen në lidhje me:
a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Dorëzimi i dokumentacionit duhet të bëhet pranë Zyres se Burimeve Njerezore në Bashkinë Lushnje, brenda dates 15.10.2025, ora 16:00.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e mësipërme do të njoftohen për përzgjedhjen e tyre nëpërmjet e-mailit zyrtar dhe shpalljes në faqen zyrtare të Bashkisë Lushnje.

DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE